



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ADGJA.nr.09/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga B.P nga Gjakova, ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit, B.B, lidhur me vendosjen në lëndën C.nr.224/14, të Gjykatës Themelore në Gjakovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1 dhe 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë **01.12.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga B.P nga Gjakova, ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit, B.B, lidhur me vendosjen në lëndën C.nr.224/14. të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

A r s y e t i m

Me datën 15.11.2022, përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës - KGJK, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ka mbërritur ankesa e ankuesit B.P nga Gjakova. Parashtruesi në ankesë ka pretenduar se gjyqtari B.B, gjatë tërë procedurës ka qenë i njëanshëm dhe nuk ka ushtruar kompetencat e tij ligjore në përputhshmëri me ligjin e aplikueshëm mbi ecurinë procedurale të çështjes kontestimore, duke lejuar administrimin e provave jo kredibile gjegjësisht në versione fotokopje, duke pasur në dijeni kundërshtimin e palës së paditur. Tutje ka theksuar se shkelja është legjitimuar edhe në instancën e dytë e po ashtu edhe Gjykata Supreme e ka refuzuar si të pabazuar revizionin e parashtruesit, me çka ka theksuar se edhe në instancën e fundit sipas mjetit juridik të jashtëzakonshëm janë konsumuar shkeljet e njëjta, andaj kryetarit të Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të ndermirën veprime për hetim-analizim dhe vlerësim të pretendimeve të lartcekurave, me qëllim që të eliminohen dilemat mbi paanshmërinë dhe objektivitetin e relatorëve përkatësisht gjyqtarëve që kanë gjykuar në çështjen e lartcekur.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datë 17.11.2022, nga gjyqtari B.B, ka kërkuar deklaram lidhur me ankesën e parashtruar nga B.P.

Gjyqtari B.B, ka dhënë deklaratë me datën 18.11.2022, ku ka theksuar se pas emërimit të tij në pozitën gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjakovë, të njëjtit i janë ndarë lëndë në punë, ku në mesin e tyre ka qenë edhe lënda e paditësit B.P nga Gjakova kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për shkak të vërtetimit të pronësisë, e cila ishte kthyer në rigjykim sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Tutje ka theksuar se pas pranimit të shkresave të lëndës dhe pas plotësimit të kushteve ligjore për mbajtjen e shqyrtimit kryesor, gjykata ka caktuar shqyrtim gjyqësor dhe ka marrë aktgjykimin C.nr.224/14, të datës 15.09.2016, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi të të pabazuar.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarit B.B, ka gjetur se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi si dhe deklaratës së gjyqtarit B.B, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket mënyrës së vendosjes, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i'u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtari është i pavarur në punë e tij, vendos sipas ligjit dhe vendimin e merr në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimit të kryetarit, pavarësia individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet të jenë meritore, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor.

Lidhur me pavarësinë në vendimmarrje nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të pavend apo të pajustificuar në procesin gjyqësor dhe nuk duhet që vendimet gjyqësore të gjykatave t'i nënshtrohen ndryshimit. Në rastin konkret Kryetari i Gjykatës nuk ka kompetencë që të ndryshoi vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjyqtari apo kolegji i gjyqtarëve dhe se pala e pakënaqur ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore i ka shfrytëzuar mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike. Aq më tepër, duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe theksimeve të vetë palës ankuese del se aktvendimi C.nr.224/14, i datës 25.03.2016, është konfirmuar në të gjitha instancat gjyqësore.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtruesit të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk u vërtetua se gjyqtari ka bërë shkelje të Kodit të Etikës. Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për

Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
ADGJA.nr.09/2022, me datë 01.12.2022

Kryetari i Gjykatës
Valon Totaj

Vendimi t'i dorëzohet:

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtarit,
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,